

Statuti i Shoqërisë

“ACTIVE WATCH SECURITY” SH.P.K

Në përputhje me kërkesat ligjit nr.9901 datë 14.04.2008, Themeluesit e Shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar më dt. 22.10.2021 nxjerrin :

**STATUTIN**

**E**

**“ ACTIVE WATCH SECURITY” SH.P.K.**

**- Shoqëri me përgjegjësi të kufizuar**

**TITULLI I**

**DATA E THEMELIMIT, FORMA E SHOQËRISË, OBJEKTI, KOHËZGJATJA, VULA**

**Neni 1**

**Data e themlimit , emertimi dhe Themeluesit**

Shoqëria “ACTIVE WATCH SECURITY” SHPK krijohet në datë 22.10.2021 si shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, nga ortakët :

Simi-Dan Pantea i datelindjes 27 Shator 1966 ne Bukuresht, Rumani dhe banues në lgj nr.2 rruga Rinia. i identifikuar me letër njoftimin nr. 1660927120650

**Neni 2**

**Personaliteti juridik**

- 2.1 Shoqëria është person juridik shqipëtar
- 2.2 Shoqëria gëzon të drejta si person juridik shqipëtar që nga momenti i regjistrimit të saj në Qëndrën Kombëtare të Bisesit.
- 2.3 Shoqëria e ushtron aktiivitetin e saj në bazë të legjisalcionit shqiptar dhe në përputhje me dispozitat e parashikuara në këtë statut themelimi.

**Neni 3**



#### Forma e shoqërisë

3.1 Shoqëria do të ketë formën e shoqërisë (shkurtimisht **SH.P.K.**) me përgjegjesi të kufizuar, derisa me vendim të Asamblesë të Përgjithshme të vendoset shndërimi i formës ligjore.

#### Neni 4

##### Objekti

4.1. Shoqëria **“ACTIVE WATCH SECURITY” SH.P.K** do të ketë si objekt veprimtarie:

- Ofrimin e shërbimit video surveillance (survejim i kamerava të sigurisë)
- Call center= ofrim i shërbimit të operatoreve telefonikë
- Help Desk
- Operatorë turistikë
- Cdo veprim tjetër tregëtar financiar që lidhet në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektet e mësipërme në përputhje me legjislacionin në fuqi.

#### Neni 5

##### Kohëzgjatja

5.1 Shoqëria **“ACTIVE WATCH SECURITY” SH.P.K** do të ushtrojë aktivitetin për një kohë të pacaktuar derisa të vendoset ndryshe nga Asambleja e Përgjithshme.

5.2 Shoqëria e fiton personalitetin e saj juridik që nga momenti i regjistrimit pranë QKB dhe që nga kjo datë mund të fillojë të ushtrojë aktivitetin tregëtar deri kur me vendim të Asamblesë të Përgjithshme të vendoset prishja e shoqërisë ose kur shoqëria mbaron në një nga mënyrat e parashikuara në ligjin “Për tregëtarët dhe shoqëritë tregëtare”.

#### Neni 6

##### Selia

6.1 Selia Kryesore e Shoqërisë do të jetë në Pogradec në adresën: Lagj nr. 3 Rr: “100 hapa drejt Europes” Pauria nr. 3/155 Z.K 8582 Vol.21 fq.163

6.2 Me vendim të Administratorit selia mund të ndryshohet, të hapen degë të tjera brenda territorit të Rep. të Shqipërisë.

#### Neni 7

##### Vula e shoqërisë

7.1 Shoqëria do të ketë vulën e saj duke shënuar në të emertimin tregëtar ose inicialet

**TITULLI II**  
**KAPITALI**

**Neni 8**

Kapitali themeltar

8.1 Kapitali Themeltar i shoqërisë do të jetë 10.000 (dhjete mije) lekë i zotëruar nga ortakët si më poshtë :

| Emri Mbiemri    | % që zotëron | Kuotat që zotëron |
|-----------------|--------------|-------------------|
| SEMI-DAN PANTEA | 100%         | 1 kuotë           |

8.2 Ky kapital është i ndarë në 1 (një)Kuotë, e cila zotërohet nga ortaku i vetem themelues Semi-Dan Pantea me vlerë të përgjithshme 10.000 (dhjete mije) leke dhe që përbën 100% të Kapitalit Themeltar.

8.3 Kapitali do të depozitohet në një Bankë në Shqipëri , me një llogari të hapur në emër të Shoqërisë në formim e sipër.

**Neni 9**

Kuotat dhe të drejtat lidhur me to

9.1 Cdo kuotë jep të drejtën e një vote për të marrë vendime sipas ligjit nr.9901 datë 14.04.2008 “Për tregëtarët dhe shoqëritë tregëtare”. Të gjitha votat do të ushtrohen nga ortakët sipas zotërimeve.

**Neni 10**

Kuotat dhe të drejtat lidhur me to

10.1 kuotat e kapitalit të shoqërisë, mundet te fitohen nëpërmjet kontributit në kapitalin e shoqërisë, shitblerjes, trashëgimisë, dhurimit apo cdo mjeti tjetër të parashikuar në ligj.

**TITULLI III**

**ASAMBLEJA E PËRGJITHSHME**

**Neni 11**

**Asmableja e Përgjithsme. Thirrja e mbledhjes. Marrja e vendimeve. E drejta e votës.**

11.1 Asambleja e Përgjithshme si organ kryesor i shoqërisë sipas ligjit “Për tregëtarët dhe shoqëritë tregëtare” përfaqësohet në këtë shoqëri nga ortakët.

11.2 Asambleja e Përgjithshme thirret me shkresë jo më vonë se 7 ditë përpara datës të mbledhes në adresat e percaktuara ne dispozitën “njoftimet”më poshtë.

Njoftimi duhet të përmbajë: ditën, orën, vëndin ku do të mbahet mbledhja si dhe rendin e ditës.

Njoftimi behet nga administratori i shoqërisë apo nga cdo ortak i cili përfaqëson të paktën 5% (pesë përqind) të totalit të votave në asamblenë e përgjithshme.



11.3 Asambleja e Përgjithshme duhet të thirret të paktën një herë në vit për të vendosur për çështje të tilla si:

Miratimi i bilancit dhe pasqyrave financiare, miratimi i raportit të auditimit të shoqërisë.

11.4 Mbledhjet mbahen në selinë e shoqërisë, apo edhe në një vend tjetër të njohur nga ortaku i vetëm.

11.5 Vendimet merren nga Asambleja e Përgjithshme

## Neni 12

### Kompetencat e Asamblesë Të Përgjithshme

12.1 asambleja e Përgjithshme është kompetente për marjen e vendimeve për shoqërinë në lidhje me çështjet e mëposhtme:

1. përcaktimin e politikave tregëtare të shoqërisë;
2. ndryshimin e statutit
3. emerimin/shkarkimin e administratorit, eksperteve kontabël, likuidatorëve
4. mbikqyrja e politikave tregëtare nga administratori, përfshirë dhe përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe raporteve të ecurisë të veprimtarisë;
5. miratimin e pasqyrave financiare dhe raporteve të ecurisë të veprimtarisë
6. shpërndarjen e fitimeve vjetore dhe mbulimin e humbjeve;
7. kryerjen e kontrollit financiar të shoqërisë me ekspertë të caktuar prej saj.
8. Të vendosë për zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit
9. të vendosë për riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë
10. çështje të tjera që janë të rëndësishme për aktivitetin tregëtar të shoqërisë

## Neni 13

### Perfaqësimi në Asamble

13.1 ortaku mund të përfaqësohet në mbledhje, në rastet kur e ka të pamundur pjesëmarrjen personalisht në mbledhje, nga një person i tretë ose dhe nga një ortak tjetër. Autorizimi duhet të këtë të përcaktuar qartë kompetencat e përfaqësimit si dhe të drejtat e tij lidhur me vendimarrjen në mbledhje.

## TITULLI IV ADMINISTRATORI

### Neni 14

#### Administratori i shoqërisë

14.1 Shoqëria administrohet nga një administrator i zgjedhur nga asambleja e përgjithshme.

14.2 administratori i shoqërisë do të jetë:

Erjon Myfari i biri i Ali; i datelindjes 22.06.1982, lindur dhe banues në Pogradec në adresë Lagjia 5 "Prroi i Caprazit" I identifikuar me leternjoftimin nr. I20622100G Afati i ushtrimit të detyrës është 5 (pesë) vjet me të drejtë ripërtëritje

## Neni 15

### Të drejtat dhe detyrimet e administratorit. Përgjegjesite.

#### 15.1 Administratori ushtron kompetencat e mëposhtme:

1. kryejnë të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikat tregtare, të vendosura nga asambleja e përgjithshme;
2. përfaqësojnë shoqërinë tregtare;
3. kryen emerimin dhe shkarkimin nga puna të punonjësve të shoqërisë.
4. jep urdhëra dhe udhëzim punëmarrësve dhe vendos sanksione ndaj tyre në përputhje me kontratat e punës dhe rregulloret e brendëshme të shoqërisë.
5. drejton dhe organizon punën në mënyrë të tillë që të sigurojë suksesin e shoqërisë në veprimatrinë e saj ekonomiko –finaciare
6. të raportojë para asamblesë së përgjithshme sa herë asambleja e kërkon si dhe në rastet kur është I nevojshëm raportimi në lidhje me zbatimin e politikave tregëtare dhe me realizimin e veprimeve të posacme me rëndësi të vecantë.
7. të zbatojë vendimet e marra nga Asambleja e Përgjithshme.
8. të paraqesë në mënyrë të rregullt dhe në kohë të përshtatshme, Asamblesë të Përgjithshme, raportin e administrimit, inventaret, bilancet dhe llogaritë vjetore si dhe të përgjigjet për to.
9. të ushtrojë të drejta dhe detyrime të tjera të përcaktuara nga ligji.
10. administratori është përgjegjës ndaj shoqërisë për shkelje të ligjit dhe statutit dhe për faje të kryera gjatë administrimit, ai nuk mban përgjegjesi financiare në rast falimentimi po likuidimi të kompanisë.

## Neni 16

### Mbarimi i mandatit të Administratorit

16.1. Mandati i Administratorit përfundon:

- me mbarimin e afatit
- me shkarkimin e tij nga Asambleja e Përgjithshme
- kur Administratori jep vetë dorheqjen vullnetarisht
- sipas mënyrave të tjera të parashikuara nga Ligji "Për Tregëtarët dhe Shoqëritë Tregëtare"

## TITULLI V

### VITI FINANCIAR.PRISHJA E SHOQËRISË. DISPOZITAT E FUNDIT

## Neni 17

### Viti Financiar

17.1 Veprimet financiare mbyllen në dtën 31 Dhjetor të çdo viti. Administratori merr masa në lidhje me nxjerrjen e bilancit të hartuar konform ligjit "Për Kontabilitetin dhe pasqyrat financiare"

## Neni 18

## Mbrimi i shoqërisë

18.1 Shoqëria ACTIVE WATCH SECURITY” SHPK mbaron:

1. me vendim të Asmablesë të Përgjithshme
2. me hapjen e procedurave të falimentit
3. sipas shkaqeve të tjera të përcaktuara ne ligjin “Për tregëtarët dhe shoqëritë tregëtare”

### Neni 19

#### Njoftimet

- 19.1 Njoftimi për ortakun duhet të kryhet sipas adreses të përcaktuar në nenin 6 të këtij statuti  
19.2 Ortaku është i detyruar të njoftojë ndryshimet në adresën e tij

### Neni 20

#### Të ndryshme

- 20.1 Për çështjet që nuk parashikohen dhe rregullohen shprehimish nga ky statut gjejne referim dispozitat e ligjit nr.9901 date 14.04.2008 “Për tregëtarët dhe shoqëritë tregëtare”  
20.2 Shoqëria ACTIVE WATCH SECURITY” SHPK regjistrohet sipas nenve 26,28 , 32 dhe 35 te ligjit 9723 datë 03.05.2007 “Per qendren Kombetare te Regjistrimit”  
20.3 Satuti u hartua në 3 kopje në gjuhen shqipe, me vlerë të njejtë juridike.

Themeluesi

SIMI DAN PANTEA

